



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 28, datë 23.05.2016

Për

“KALIMIN E FUNKSIONEVE TË MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE RURALE, UJITJES DHE KULLIMIT PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME NR. 2 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT, SI DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE, PRANË AGJENCISË SË PARQEVE DHE REKREACIONIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 21, pika 2, nenit 22, nenit, 23, pika 4, nenit 27 pikat 1 dhe 5, neni 54 “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; pikave 5, 6 dhe 7 të Aneksit 4 “Për funksionet që financohen me transferta specifike për vitin 2016 të Ligjit 147/2015, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2016”: Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e qarqeve tek Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këyre rrugëve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1108, datë 30.12.2015 për “Transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.21, datë 13.02.2001 për “Miratimin e krijimit të Ndërmarrjes nr.2 të punëtorëve të qytetit”; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.41, datë 23.09.2015 “Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 58 data 31.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” (i ndryshuar); Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr.3185, datë 01.02.2016 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit nr.56, datë 24.12.2012 për “Riorganizimin e struktures organizative të disa institucioneve në Varësi të Bashkisë së Tiranës”; Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr.3190/1, datë 01.02.2016, “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit nr.56, datë 24.12.2012 për “Riorganizimin e struktures organizative të disa institucioneve në Varësi të Bashkisë së Tiranës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kalimin e funksioneve të mirëmbajtjes së rrugëve rurale, të ujitjes dhe kullimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit.

1.1 Detyrat funksionale që i shtohen kësaj drejtorie për të mirëmbajtjen e rrugëve rurale, do të jenë si më poshtë vijon:

- a. Hartimin në përputhje me legjislacionin në fuqi projekt buxhetin për mirëmbajtjen. Sipas programit të miratuar nga organet e prore marrin të gjitha masat për realizimin e elementeve të tij, organizojnë furnizimin materialo - teknik, si dhe gjithë aktivitetin teknik të mirëmbajtjes të rrjetit rrugor që ka në administrim.
- b. Realizimin e procedurave të prokurimit të investimeve e të shpenzimeve operative, studime, projektme, mirëmbajtje, rehabilitime konform legjislacionit përkatës aktual.
- c. Hartimin e prioritetet e punimeve për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor, te cilat miratohen në fillim të vitit së bashku me buxhetin.
- d. Projekt preventivat e hartuara në ndërmarjet të shoqëruara nga grafiku i punimeve, specifikimet dhe shënimet teknike miratohen nga Drejtoria e Monitorimit të Rrugëve Rurale, brenda Bashkisë së Tiranës .
- e. Mirëmbajtja e punimeve bëhet nga specialistë të DPND2, ndërsa kolaudimi i punimeve monitorohen nga Drejtoritë përkatëse brenda Bashkisë së Tiranës.
- f. Financimi i punimeve kryhet sipas situacioneve mujore dhe përfundimtare të punimeve. Situacioni përfundimtar, hartohet e nënshkruhet pas marrjes në dorëzim të objektit.
- g. Marrin masa për ruajtjen e pronës që kanë në administrim dhe përgjigjen për dëmtimin e saj.
- h. Informon çdo muaj për gjendjen e rrjetit rrugor në administrim të tyre kundrejt strukturave përkatëse.
- i. Informacion të vazhdueshëm drejtoria jep edhe në rastet e emergjencave civile pranë Drejtorisë së Emergjencave Civile pranë Bashkisë së Tiranës në mënyrë që të merren masa e nevojshme për përballimin e tyre.

1.2 Detyrat funksionale që i shtohen kësaj drejtorie për ujitjen dhe kullimin do të jenë si më poshtë vijon:

- a. Pastron dhe mirëmban kanalet kulluese, mbledhëse, tubat dhe strukturat;
- b. Shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit, hidrovoret dhe kontrollon cilësinë e ujit që kullohet;
- c. Mirëmban dhe rregullon sistemet kryesore të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja;
- d. Merr masa për menaxhimin e përrrenjve, kur është e nevojshme, për të parandaluar ose zvogëluar ndikimet e erozionit.
- e. Bashkia e Tiranës do të koordinojë punën për planifikimin e nevojave për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtje dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit me strukturat Rajonale të Ministrisë.
- f. Shfrytëzon dhe mirëmban çdo sistem kullimi dhe vepër mbrojtjeje nga përmytja brenda zonës përkatëse nën shërbim, në mënyrë që të largojë ujën e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit dhe të parandalojë përmytjen.
- g. Pastron dhe mirëmban kanalet kulluese, mbledhëse, tubat dhe strukturat;
- h. Shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit, hidrovoret;
- i. Kontrollon cilësinë e ujit që kullohet;
- j. Kontrollon, mbikëqyr, mirëmban dhe rregullon sistemet kryesore të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja.

2. Të miratojë kalimin e funksionit të administrimit të pyjeve dhe kullotave pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit. Detyrat funksionale që i shtohen kësaj agjencie janë si më poshtë:

- a. Mbrojtja dhe zhvillimi i pyjeve dhe kullotave;

- b. Organizimi dhe implementimi i planeve operacionale të mbarështrimit të pyjeve;
 - c. Organizimi i shërbimit pyjor dhe inspektimit të pyjeve dhe kullotave.
 - d. Mbrojtja e fondit pyjor e kullor nga faktorët e ndryshëm biotikë dhe abiotikë dhe marrja e masave për përmirësimin e gjendjes;
 - e. Mbarështimi i fondit pyjor dhe kullor brenda territorit administrativ nëpërmjet hartimit, përditësimit dhe monitorimit të planit të mbarështimit dhe kullotave;
 - f. Hartimi i planeve operacionale për aktivitetet vjetore në pyje dhe kullota, bazuar në të dhënat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave;
 - g. Përgatitja e projekt-planit vjetor buxhetor për të plotësuar nevojat financiare të operacioneve dhe masave teknike, të parashikuara për t'u kryer në sipërfaqet dhe fondin pyjor/kullor në pronësi, për vitin pasardhës buxhetor;
 - h. Hartimi i projekteve tekniko-ekonomike të zbatimit për realizimin e masave të rekomanduara ose planifikuara nga planet e mbarështimit, për trajtimin e pyjeve dhe kullotave, si dhe për punimet e tjera dhe ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme.
3. Efektet financiare të zbatimit të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit për vitin 2016.
 4. Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të këtij të përgatiten ndryshimet në strukturat organizative të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit dhe e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit t'i paraqiten për miratim Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.
 5. Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi të përgatiten ndryshimet në rregulloret për funksionimin e brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit dhe të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, të cilat do të paraqiten për miratim tek Kryetari i Bashkisë së Tiranës, jo më vonë se 45 ditë pas miratimit të srukturave organizative.
 6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për ndjekjen e procedurave të indentifikimit dhe kalimit kapital të asetëve e pasurive të paluajtshme objekt i ushtrimit të detyrave funksionale të shtuara sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi.
 7. Për zbatimin këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Asetëve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
 8. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI